




Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU  
ENERGY REGULATORY OFFICE



Nr. 100/24  
Data. 06.02.24



Prishtinë: 29.01.2024  
Kodi i ZRRE-së :V\_1869\_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,  
Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nën paragrafin 1.7, Nenin 25 dhe Nenin 26 par. 1 nënpar. 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Rregullën Nr. 03/2023 për Vet-Konsumatorët me Burime të Ripërtitshme;
- Nenin 28 paragrafi 5 i Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji; dhe
- Kërkesën e datës 12.01.2024 për aprovimin e dizajnit të ri të faturës së energjisë elektrike për vet-konsumatorët me burime të ripërtitshme nga Furnizuesi me Shërbim Universal - KESCO

në seancën e mbajtur më datë 29.01.2024 nxori këtë:

#### VENDIM

- I. **APROVOHET** - Dizajni i Faturës së energjisë elektrike për vet-konsumatorët me burime të ripërtitshme, e cila do të zbatohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
- II. **OBLIGOHET** - Furnizuesi me Shërbim Universal KESCO, që të zbatoj Dizajnin e Faturës së energjisë elektrike për vet-konsumatorët me burime të ripërtitshme.

#### Arsyetim

- ZRRE me datë 12.01.2024 ka pranuar nga furnizuesi KESCO kërkesën për aprovimin e dizajnit të ri të faturës për vet-konsumatorët me burime të ripërtitshme e cila do të zbatohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
- Kjo kërkesë e KESCO-s ka ardhur si rrjedhojë e kërkesave ligjore të parapara me nenin 28 paragrafin 5 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji elektrike si dhe Rregullës për Vet-Konsumatorët me Burime të Ripërtitshme.
- KESCO në kërkesën e tyre ka potencuar se dizajni i ri është përpunuar me qëllim të përmirësimit të kriterëve të përcaktuara në Kreun III të Rregullës për Vet-Konsumatorët me Burime të Ripërtitshme.
- Bordi i ZRRE-së ka shqyrtuar kërkesën e Furnizuesi KESCO dhe vlerëson se dizajni i ri i faturës i plotëson kërkesat e dalura nga neni 28 i Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji dhe Rregullës për Vet-Konsumatorët me Burime të Ripërtitshme përkatësisht fatura e re do të përmbaj të gjitha informatat si: komponentin e energjisë së reduktuar, ngarkesën e pa reduktuar të rrjetit, komponentin e tarifës të pa reduktuar, e që do të prezantohen qartë dhe në mënyrë transparente.



- Vendimi nxirret dhe publikohet ne gjuhet zyrtare në Republikën e Kosovës.
- Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bashkangjitur këtij Vendimi:** Dizajni i Faturës për vet-konsumatorët me Burime të Ripërtrishme.


**Bordi i ZRRE-së:**

  
Ymer Fejzullahu, kryesues

  
Lutfije Dervishi, anëtare

  
Gani Bucaj, anëtar

  
Aneta Qorolli, anëtare

  
Adnan Preniqi, anëtar

**Vendimi u dërgohet:**

- Furnizuesit me Shërbim Universal KESCO dhe
- Arkivit të ZRRE-së.